



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 03, datë 22.01.2021

“MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, VKM–në Nr. 597, datë 04.09.2019, kreu IV, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
 - a. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 - b. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 - c. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 - d. Familje me shumë fëmijë.
 - e. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin.
 - f. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë me paaftësi/invalide pune.
 - g. Familje që kanë një antar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
2. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM- së Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI



Rruga: “Pasho Hysi” Lagjja: “Çlirimi” Çorovodë, Skrapar Telefon: +355 31222512email: bashkiacorovode@ymail.com

